

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë kontestimore e shkallës së parë, sipas gjyqtarit Nexhat Aliu me sekretaren juridike Azize Rama, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit M (H) A. nga fsh.S. e E. K.Vitisë, kundër të paditurve L.(N.) N.A. (F.) N.i dhe S. (B.) N. që të tre nga fsh.S. e E. K.Vitise, baza e kontestit vërtetimi i te drejtes se pronesisë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, me datë 20.12.2016, shpallë këtë:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET kërkesëpadia e paditësit M. (H) A. nga fsh. S. e E. K.Vitisë dhe **i njihet** e drejta e pronësisë në ngastrën e re kadastrale nr. xxx në sipërfaqe prej xxxx m², në vendin e quajtur “P.. . Dxxx” sipas ekspertizës së dt.xxxx, e regjistruara në emër të pronarëve juridik N.. N. (Xh) N...i F. (Xh.) N. B.(Xh.) që të tre nga fsh.S. e E. K.Vitise , **në bazë të shitblerjes.**

DETYROHEN të paditurit L. N., A. N.i dhe S. N. nga fsh S. e E. K.Vitise, t’ia njohin të drejtën e pronësisë paditësit M. A. nga fsh.S.E. K.Vitise ,dhe të durojë që ngastrën e lartpërmendur ta regjistroj në emrin e paditësit.

Ky aktgjykim për Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Vitisë, paraqet bazë, që në regjistrat kadastralë, të bëhet ndryshimi.

II. Shpenzimet e procedurës do t’i heq paditësi.

A r s y e t i m

Paditesi M. A. ka deklaruar mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padijes dhe ka kerkuar nga Gjykata që ti njihet e drejta e pronësisë në ngastrën kadastrale xxxx, në vendin e quajtur “x xxx” në sipërfaqe prej xxx m², ZK.Sxxx, nga se kete ngaster e ka blere nga A.. Xh.. N... në vitin xxxx, në qmim të përgjithshëm prej xxxx Euro, ku ja ka dhene të hollat të gjitha, dhe ka hyre në posedim dhe shfrytezim pa u penguar nga askush.

I padituri i parë L. N. N. ka deklaruar nuk e kundërshton padinë e asë kërkesë padijen nga se është e vërtetë se M. A. ka blerë një pjesë të ngastres xxxx në vendin e quajtur “P. ...” në sipërfaqe prej xxx m², dhe kërkoj nga Gjykata që Gjykata të ja njehe të drejtën në pronësi në këtë pjesë që e ka blerë nga pronari faktik A. N...

I padituri i dytë A. F. N. ka deklaruar nuk e kundërshton padinë e asë kërkesë padijen nga se është e vërtetë që paditësi M.A. ka blerë një pjesë të ngastrës kadastrale xxxx, në një sipërfaqe prej xxx m², në vendin rreth varrezave, nga djali i mixhe të A. N.. dhe nuk e kundërshton që kjo parcelle të dele në emër të paditësit M.A...

I padituri i tretë S...B.. N.. ka deklaruar se nuk e kundërshton padinë e asë kërkesë padijen nga se është e vërtetë se paditësi M.. A... ka blerë një pjesë të ngastres xxxx në vendin e quajtur “P.. ...” e ka blerë përsej vorreve, para xx viteve, nga djali i mixhes të A.. N...

Dëshmitari A... N... ka deklaruar se unë jam pronar faktik i kesaj pjesë të ngastres xxxx në vendin e quajtur “P,.. i d...” për rreth vorreve, dhe ja kam shitur një pjesë të kesaj ngastre paditësit M. A.. në sipërfaqe prej xxx m², ku kam marrë qmimin e shitblerjes në tërësi dhe paditësi ka hyrë në posedim dhe shfrytezim pa u penguar nga askush, andaj kërkoj që ti njihet e drejta e pronësisë nga se me është paguar në tërësi.

Paditësi M. A. i propozon Gjykatës me qense ngastra nuk është e ndarë dhe është si tërësi që gjykata të dele sëbashku me eksperte të gjeodezisë në vendin e ngjarjes me qëllim që të bene ndarjen fizike të kesaj pjese.

Paditësi M. A., i propozoi gjykatës që gjykata së bashku me eksperte të gjeodezisë të dele në vendin e ngjarjes të bëjë identifikimin e ngatres xxxx ZK.S. e E....

Gjykata së bashku me ekspertin e gjeodezisë ka dalur në vendin e ngjarjes me dt.xxxxx ka bërë identifikimin e ngatres nr.xxxx, në të cilën ngaster ishte duke u ndertuar një objekt me material të forte.

Në procedure e provave u lexuan : qertifikata me nr.xxxx e dt.xxx, në emer të N... N... (Xh.) N.. F. (Xh.) N. B.(Xh.), kopja e planit me nr.xxxx dt.xxx, dhe u lexua ekspertiza e dt.xxx e përpiluar nga eksperti i gjeodezisë.

Paditësi M. A. në fjalën perfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padise dhe kërkoj nga Gjykatë që ti njihet e drejta e pronësisë në ngastren e re kadastrale e cila e mban nr.xxx ZK.S. e E.me një sipërfaqe prej xxx m², kjo ngaster e re është krijuar pas daljes së Gjykatës në teren, së bashku me ekspert të gjeodezisë, dhe është ndare nga ngastra xxxx, andaj mendonte se është vërtetuar mjaftë pasë ndëgjimit edhe të paditëve në seancat e me pareshme, nuk e kanë kundërshtuar padin e asë kërkesë padine dhe asë ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë, andaj i propozoi gjykatës të merr aktgjykim meritore sipas ligjit dhe të me njihet e drejta e pronësisë në ngastren e re nr,xxx-2 ZK.S. E..

I padituri i L.. N...i në fjalën perfundimtare ka deklaruar edhe pasë ndarjes së kesaj ngastre që është krijuar ngastra e re nr.xxxx, nuk e kundërshtojmë padin e asë kërkesë padin dhe ka kërkuar që ti njihet e drejta e pronësisë paditësit M. A.,,

I padituri i S. N.. në fjalën perfundimtare ka deklaruar edhe pasë ndarjes së kesaj ngastre që është krijuar ngastra e re nr.XXXX, nuk e kundërshtojmë padin e asë kërkesë padin dhe kërkoj që ti njihet e drejta e pronësisë paditësit M.A...

Gjykata analizoi thenjet e palve ndërgjygjse, provat e administruara dhe konstatoi: se ngastra kadastrale nr.XXXX, evidentohet në emër të të paditurve N. N. (Xh.) me 1/5, të ngatres kadastrale, N. F. (Xh.) me 3/5, të ngatres kadastrale, N. B. (Xh.) me 1/5, të ngatres kadastrale, e cila ngastër pasë daljes në teren të gjykatës me ekspert të gjeodezisë është ndarë dhe ka marrurë numrin e ri si ngaster e re xxx2, në sipërfaqe xxx m², të cilën ngaster paditësi M. A.. e kishte blerë nga pronari faktik A. Xh. N. dhe ja kishte paguar në tersi qmimin e kontraktuar dhe kishte hyer në posedim dhe shfrytëzim pa u penguar nga askushë ku një gjë të tillë nuk e kishin kundërshtuar asë të paditurit L. N., A. N dhe S..N të cilët kishin deklaruar që ti njihet e drejta e pronësisë paditësit M.A. ,per kete arsye iu njihet e drejta e pronësisë, paditësit M. A. nga fshati S. E., si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN -DEGA NE VITI

C.nr. 30/2016

Me 20.12.2016

Sekretare Juridike:
Azize Rama

Gjyqtari
Nexhat Aliu

Keshilla juridike:kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankese, ne afat prej 15 ditesh nga dita e marrjes, ne Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kesaj gjykate.